



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT  
DHE TELEKOMUNIKACIONIT

# **Plani i Integruar i Ministrisë 2010**

Mars 2010

## Mesazhi i Ministrit

Të nderuar qytetarë,



Plani i Integruar i Ministrisë për vitin 2010, sikurse dhe Planet e Integruara të Ministrisë të përgatitura vitet e mëparshme, përmbledh në të angazhimet e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit gjatë vitit 2010, në kuadër të zhvillimit të të gjithë sektorëve të veprimtarisë së saj, përmes së cilave ne do të synojmë përmbushjen e objektivave të përcaktuara në Programin e Qeverisë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian dhe anëtarësimi në NATO, realizimi i të cilave mbështetet tërësisht në Programin Buxhetor Afatmesëm 2008-2010.

Hartimi i këtij plani synon të mbështesë përpjekjet tona për të arritur një zhvillim ekonomik - social që do të ndikojë në përmirësimin e jetës së qytetarëve tanë.

Synimi kryesor i zhvillimit të sektorit të transportit është integrimi i rrjetit rrugor shqiptar në atë rajonal dhe evropian, duke përshpejtuar ritmet e zbatimit të projekteve të infrastrukturës së transportit me ndikim kombëtar, rritjen e standardeve të sigurisë rrugore, përmirësimin e kushteve që do të mundësonin lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të mallrave.

Komercializimi dhe studimi i rajonalizimit të sektorit të ujësjellës - kanalizimeve si dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit në këtë fushë do të jenë një tjetër drejtim i rëndësishëm ku do të vazhdojë të fokusohet puna jonë gjatë vitit 2010.

Thellimi i reformës së decentralizimit të strehimit dhe ngritjes së kapaciteteve të nivelit vendor, vis-a-vis me nxitjen e sektorit privat janë prioritete të politikave të strehimit të kësaj Ministrie, të cilat synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të popullsisë.

Puna jonë do të mbështetet fuqimisht edhe në bashkëpunimin e ngushtë me donatorët e huaj dhe institucionet ndërkombëtare financiare, prezenca e të cilëve ka qenë e dukshme dhe domethënëse për të gjithë sektorët e veprimtarisë së MPPTT.

Në përfundim, dëshiroj të theksoj se PIM-i i vitit 2010 do të shërbejë si një tregues monitorimi dhe vlerësimi i punës së MPPTT-së gjatë këtij viti dhe si bazë për hartimin e planeve të tjera të integruara që do të hartohen në vitet e ardhshme.



Sokol Olldashi

Ministër i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

## Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë .....	5
2	Dokumentet strategjike të Ministrisë .....	9
3	Programet buxhetore të Ministrisë .....	13
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2010.....	16
5	Plani i Monitorimit i Ministrisë .....	29
Aneks 1	Programi i përgjithshëm analitik i projektakteve për vitin 2010 .....	30
Aneks 2	Rezultate që lidhen me Integrimin Evropian.....	36
Aneks 3	Investimet publike .....	37
Aneks 4	Projekte të ndihmës së huaj .....	38
Aneks 5	Plani i veprimit antikorrupsion për vitin 2010 .....	41

## 1 Misioni i Ministrisë

Misioni i MPPTT është formulimi, zbatimi dhe monitorimi i politikave, programeve, normave dhe standarteve kombëtare për infrastrukturën rrugore, transportet, shërbimet publike, planifikimin hapësinor dhe strehimin, me synim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe promovues për investimet private dhe rritjen ekonomike, duke përdorur burimet e disponueshme në mënyrë sa më produktive, efektive dhe të drejtë.

Fusha e veprimtarisë së MPPTT

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit vepron mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe në akte ligjore dhe nënligjore.

Objekti i veprimtarisë së Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në përbërje të strukturës së Qeverisë së Republikës së Shqipërisë është:

Përgatitja dhe zbatimi i objektivave dhe politikës ekonomike të Qeverisë Shqiptare për zhvillimin e punëve publike, transportit dhe telekomunikacionit në të gjithë elementet përbërës të tij (infrastrukturë, mjete, operim, etj), në shkallë kombëtare e ndërkombëtare; Hartimi i politikave të zhvillimit të punëve publike, transportit rrugor, hekurudhor, detar, ujqor, ajror dhe telekomunikacion dhe ndjekja e zbatimit të këtyre politikave në hallkat e varësisë;

Përcaktimi i tendencave dhe prirjeve nga analizat e llojeve të punëve publike, transportit dhe telekomunikacionit mbi bazën e statistikave dhe sistemeve të informacionit në ndërtim, transport dhe telekomunikacion dhe hartimi i treguesve makro-ekonomike të zhvillimit të përgjithshëm të ndërtimit dhe transportit afatshkurtër dhe afatgjatë; hartimi, zberthimi dhe ndjekja e treguesve të projekt - programeve ekonomike financiare, të investimeve, etj;

Grumbullimi i projektplaneve vjetore të njësive shtetërore në varësi të saj për hartimin e projekt programeve makro - ekonomike të degës së ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit për mbikëqyrjen dhe pasqyrimin e parametrave e të treguesve të strategjive të zhvillimit të ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit;

Negocimi dhe bashkërendimi i punës me ministritë e tjera dhe institucionet ndërkombëtare financiare e shtete të ndryshme për sigurimin e burimeve të financimit të domosdoshme, në mënyrë që të krijojë mundësi zhvillimi dhe harmonizimi të llojeve të ndërtimit dhe transportit, për të mbështetur zhvillimin e ekonomisë së vendit, përmirësimin e lëvizjes së udhëtarëve dhe të kërkesave të transportit evropian;

Drejtimi, menaxhimi, mbikqyrja dhe vendosja e standardeve teknike të infrastrukturës së rrjeteve rrugore e hekurudhore, të porteve, pontileve e kalatave (në digat e hidrocentraleve) dhe aeroporteve;

Krijimin e një atmosfere të sigurtë pune në Portet e hapura të Republikës së Shqipërisë (porti i Durrësit, Vlorës, Shëngjinit, Sarandës), mjetet detare që kryejnë veprimtari në këto porte dhe të gjithë përdoruesit e tjerë, duke vendosur kontrolle të rrepta të hyrjeve, patrulla në toke dhe det si dhe duke përdorur pajisjet e vëzhgimit.

Shqyrtimi dhe propozimi i burimeve të financimit të brendshëm e të jashtëm (me donatorë të huaj) të harmonizuar me burimet ekonomike të ndërtimit dhe transportit për të mbuluar nevojën e zhvillimit të ndërtimit dhe transportit, si dhe rishpërndarja e tyre sipas fushave të ndryshme të veprimtarisë së MPPTT-së.

Zhvillimi i hapësirës së iniciativës së lirë private në aktivitetet e shërbimit të llojeve të transportit, si dhe krijimi i kushteve për një konkurrencë të drejtë ndërmjet llojeve të transportit, në veçanti në transportin e udhëtarëve (me autobusë, mikrobusë, taksitë e trenat), nëpërmjet ndërtimit të sistemit fiskal vetëveprues e deri në hartimin e tarifave tavan, zhvillimin e konkurrencës në sistemin e liçensimit, etj.

Hartimi i platformës së privatizimit të aktiviteteve të sektorëve përkatës strategjik, si dhe përgatitja dhe krijimi i kushteve për transferimin e pronësisë shtetërore në pronë private.

Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm ligjor, financiar dhe institucional, në mbështetje të nismës private dhe të reformës së decentralizimit, me synim rritjen e aksesit në strehim të përballeshëm të familjeve shqiptare, përmirësimin e kushteve të tyre të banimit dhe ruajtjen dhe rritjen e vlerës së banesave ekzistuese.

Drejtimi dhe synimi për përmirësimin, zgjerimin dhe zhvillimin e shërbimeve të informacionit në ndërtim, transport dhe telekomunikacion për sigurimin e burimit të të dhënave të gjithanshme e të vazhdueshme për drejtimin e ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit, për krijimin e kushteve lehtësuese të të gjithë përdoruesve dhe operuesve vendas e të huaj, si dhe të përshtatshme e të adaptueshme për t'u inkuadruar në sistemet evropiane të informacionit.

Përcaktimi dhe vendosja e standardeve për të gjithë llojet e mjeteve të transportit dhe organizimi i drejtimit e kontrollit shtetëror të sigurisë teknike në sferën e shfrytëzimit.

Përcaktimi dhe miratimi i dokumentacionit teknik dhe ekonomik të domosdoshëm për kryerjen e procesit të transportit për të gjithë llojet e mjeteve të transportit.

Organizimi i kontrollit ekonomik - financiar dhe administrativ në institucionet dhe njësitë ekonomike në varësi të Ministrisë.

Hartimi i politikës së zhvillimit të burimeve njerëzore të punëve publike, transportit dhe telekomunikacionit si dhe organizimi dhe drejtimi i përgatitjes dhe kualifikimit të specialistëve në sistemin e ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit.

Zhvillimi i negocimit, kryerjes së përgatitjeve dhe nënshkrimit (me autorizim të organeve kompetente) të marrëveshjeve në fushat e ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit me shtete të ndryshme, duke rregulluar marrëdhëniet ndërkombëtare në bazë të legjislacionit kombëtar e ndërkombëtar, si dhe i referohet rekomandimeve të Komunitetit Evropian dhe të organizatave ndërkombëtare të ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit, në të cilët vendi ynë aderon dhe ndjekja e zbatimit të tyre.

Kryerja e negocimeve për zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit, si dhe përgatitja e domosdoshme për zgjerimin e aderimit të vendit tonë në organizatat ndërkombëtare dhe ndjekja e zbatimit të tyre.

Përgatitja e një sistemi ligjor e rregullues, sipas kërkesave e standardeve Evropiane.

Përgatitja e projekt-ligjeve dhe projekt-akteve nëligjore për përmirësimin e zhvillimit të llojeve të ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit e të shtrirjes së teknologjisë e të standardeve të reja në sferën e operimit të ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit, të rregullave e të standardeve të reja në fushën e teknikës së prodhimit, shërbimit e të mirëmbajtjes së mjeteve të ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit.

Kryerja, përmirësimi dhe zhvillimi i reformës institucionale në sektorët e ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit, me synim transformimin e përgatitjen shkallë - shkallë të institucioneve në fjalë për të qenë sa më afër standardeve evropiane.

Hartimi i politikave kombëtare në fushën e planifikimit urban që shërbejnë si bazë në hartimin e kuadrit të plotë ligjor dhe në përmirësimin e mëtejshëm të tij. Koordinon e bashkërendon punën në fushat e tjera të ekonomisë dhe të pushtetit vendor. Ka përgjegjësinë e monitorimit, programimit dhe menaxhimit të të gjitha aktiviteteve për zbatimin e programit të Qeverisë për planifikimin territorial, duke respektuar legjislacionin në fuqi.

Hartimi i politikave të zhvillimit në fushën e qarkullimit dhe sigurisë rrugore, që bëjnë të mundur parandalimin dhe minimizimin e aksidenteve rrugore, nëpërmjet aplikimit të normave, standardeve dhe direktivave evropiane, të pasqyruara në legjislacionin bazë të transportit rrugor, për të gjithë komponentët me karakter institucional dhe legjislativ, në shërbim të sigurisë së lëvizjes të përdoruesve të rrugës.

Përafrimi i legjislacionit në fushën e sigurisë rrugore, me vëmendje kryesore në futjen e procedurave të reja të auditimit dhe inspektimit të infrastrukturës rrugore, si dhe ndotjen e mjedisit nga mjetet, vendosjen e standardeve në nxjerrjen e gazrave nga automjetet e rënda dhe nivelet e zhurmave, duke synuar rritjen e sigurisë rrugore.



## 2 Dokumentet strategjike të Ministrisë

### Strategjia sektoriale e planifikimit urban dhe e strehimit

Me fillimin e punës së Agjencise Kombetare të Planifikimit të Territorit, e cila është miratuar me VKM Nr.1190, datë 13.11.2009, do të vijojë puna për hartimin dhe finalizimin e Strategjisë Sektoriale të Planifikimit Urban dhe Strehimit si dhe akteve të tjera nënligjore parashikuar në ligjin “Për planifikimin e territorit”. Në kuadër të strategjise së ndërmjetme të Planifikimit Urban dhe Strehimit, objektivat që synohet të arrihen gjatë vitit 2010 janë:

- Të sigurojë kushtet për strehimin e rreth 11% të familjeve të cilat kanë aplikuar pranë bashkive;
- Vazhdimi i punimeve civile për përmirësimin e infrastrukturës dhe sistemit të ujësjes-kanalizimeve për zonen bregdetare;
- Hartimi i planit Rregullues të qarkut Elbasan dhe financimi i studimeve për përfundimin e planeve rregullues të qyteteve Durrës, Shkodër, Kamëz, Vlorë;
- Legalizimi dhe përpunimi i informacionit teknik ligjor për rreth 100 000 pasuri informale.

### Strategjia sektoriale e furnizimit me ujë dhe shërbimit të kanalizimeve të ujrave të përdorura

Strategjia sektoriale e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujrave të përdorura është diskutuar në Komitetin e Planifikimit Strategjik (KPS), është konsultuar me komunitetin e donatorëve dhe grupet e interesit. U reflektuan komentet dhe sugjerimet e dhëna dhe është dërguar për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.

Strategjia i kaloi fazat e konsultimeve, dhe në kuadër të inisiativave ligjore dhe administrative të Reformes në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, të ndërmarra me mbështetjen dhe mbikqyrjen e Bankes Botërore, pritet finalizimi i Strategjisë nga Banka Botërore dhe miratimi në Këshillin e Ministrave.

### Strategjia sektoriale e transportit

Strategjia sektoriale e transportit është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1214 datë 3.09.2008 (Fletore Zyrtare nr. 145/08). Plani i Veprimit për zbatimin e

strategjisë sektoriale të transportit është miratuar nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit. Plani i Veprimit përfshin periudhën 2008-2013.

## Qëllimet

Politika e institucionit të MPPTT është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

Përmirësimi në vazhdimësi i aftësive drejtuese të stafit të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe niveleve të tjera të vendimmarrjes, nëpërmjet zhvillimit të karrieres si dhe trajnimit sipas nevojave të nëpunësve, në mënyrë të tillë që formulimi dhe zbatimi i politikës së institucionit të jetë i mirëkoordinuar dhe veprimtaria e saj të jetë efiçente dhe efektive nga pikëpamja ekonomike si dhe e shërbimeve të tjera që ministria ofron;

Zbatimi me korrektësi i legjislacionit të shërbimit civil;

Përafrimi i legjislacionit në fushën e sigurisë rrugore me direktivat e BE-së;

Rritja e sigurisë së qarkullimit rrugor, reduktimi i aksidenteve rrugore, në mbështetje të nismës Europiane “Vizion zero” me pikësynim në uljen 10% për vitin e parë duke shkuar në 50 % deri në vitin 2014;

Përmirësimi i cilësisë së shërbimit duke rritur orët e furnizimit me ujë në shkallë vendi me 18 orë/ditë deri në vitin 2015;

Rritja e mundësive të furnizimit nga sistemet e ujësjellësit, për popullsinë e zonave urbane deri në 95%, dhe të zonave rurale deri në 77%, parashikuar deri në vitin 2013;(kjo mund të hiqet)

Rritja e mundësive të furnizimit nga sistemet e ujësjellësit, për popullsinë e zonave urbane deri në 95%, dhe të zonave rurale deri në 77%, parashikuar deri në vitin 2013;

Rritja e mundësive të furnizimit nga sistemet e ujësjellësit, për popullsinë e zonave urbane deri në 98%, dhe të zonave rurale deri në 83%, parashikuar deri në vitin 2015;

Rritja e mundësive të lidhjes me sistemet e kanalizimeve, për popullsinë e zonave urbane deri në 85%, dhe të zonave rurale deri në 69%, parashikuar deri në vitin 2015;

Rritja e cilësisë së shërbimit për popullsinë e lidhur me sistemet e KUZ nëpërmjet trajtimit të ujrave të zeza deri në 50%, deri në vitin 2015;

Përafrimi i kostos totale të shitjes së ujit dhe largimit të ujrave të përdorura me çmimin mesatar ujësjellës-kanalizime;

Sigurimi furnizimit me ujë pa ndërprerje 24 orë/ditë dhe lidhje me sitemin e kanalizimeve për të gjithë popullsinë e zonave turistike;

Krijimi i një sistemi rregullator dhe ligjor sipas kërkesave dhe standardeve evropiane, i cili do të garantojë lehtësimin e hyrjes në treg të transportuesve, operime optimale të shërbimeve të transportit në bazë të një konkurrimi të nivelit të lartë si dhe uljen e barrierave jo-fizike;

Përafrimi i legjislacionit të transportit rrugor me direktivat e BE-së;

Krijimi i një infrastrukture rrugore të integruar në planin kombëtar, rajonal dhe pan-Evropian, synimi final i të cilës është krijimi i një rrjeti unik transporti pa bllokime dhe ndërprerje, që do të mundësonte afrimin e tregjeve, rritjen e mobilitetit, evitimin e zonave të super populluara, në mbështetje të zhvillimit ekonomik;

Zhvillimi i rrjetit bazë (Core Network), që mundëson shtrirjen ndërkombëtare të rrjetit drejt shteteve fqinje në kuadrin e zhvillimit rajonal. Realizimi i korridoreve të transportit rrugor: “Korridori VIII” që përfshin aksin transnacional Juglindor, “Korridori Durrës-Morinë” që siguron lidhjen me Korridorin X, “Aksi Veri-Jug” që lejon lidhjen e Greqisë me Malin e Zi nëpërmjet territorit shqiptar dhe “Boshti Qëndror-Jugor (deri në vitin 2014);

Ndërtimi i rrugës së Arbërit (degëzim i Korridorit VIII) lidhje më e shkurtër midis Shkupit dhe Tiranës, si dhe i rrugës Koman-Fierzë që shmang vështirësitë e kalimit aktual dhe lidhje më e shkurtër me Kosovën, nëpërmjet Gjakovës (deri në vitin 2015);

Përmirësimi i mirëmbajtjes së rrjetit rrugor kombëtar nëpërmjet sistemit të menaxhimit të pasurive rrugore (SMPRr), bazuar në Planin Kombëtar të Transportit dhe synimi për privatizimin plotësisht të shërbimeve.

Rritja e transportit hekurudhor të mallrave, sepse ky transport gjeneron të ardhura të konsiderueshme;

Kryerja e transportit hekurudhor të udhëtarëve në kushtet e një sistemi hekurudhor funksional. Parashikohet operimi i shumë trenave në transportin publik, me standarde të përmirësuara të shfrytëzimit, sidomos në zonat më të populluara;

Përmirësimi i gjendjes së infrastrukturës hekurudhore, që të ketë një nivel normal të sigurisë, të besueshmërisë dhe të ketë një nivel të lartë të shpejtësisë. Bazuar në trafikun e pritshëm, parashikohet të ndërhyhet fillimisht në trungun kryesor hekurudhor Tirane-Durrës-Elbasan dhe Vore-Shkodër-Kufi, me qëllim rritjen e trafikut të mallrave që të gjenerohen të ardhura për administrimin e infrastrukturës.

Integrimi i rrjetit tonë hekurudhor në rrjetin rajonal dhe evropian në përputhje me Marrëveshjen shumëpalëshe “Për ngritjen e një rrjeti hekurudhor, të performancës së

lartë, në Evropën Juglindore”, miratuar me Ligjin nr. 9620, datë 16.10.2006 (Fletorja Zyrtare nr. 188, datë 17.11.2006, faqe 4731);

Përmirësimi i kuadrit ligjor, nëpërmjet hartimit të Kodit të ri Hekurudhor;

Vazhdimi i ristrukturimit të Hekurudhës Shqiptare sha. për ndarjen e mëtejshme të llogarive midis njësive të biznesit;

Ndjekja e implementimit të studimeve të realizuara në fushën e transportit hekurudhor;

Ndërhyrje minimale në infrastrukturën hekurudhore dhe në mjetet lëvizëse ne përputhje me fondet e akorduara.

### **3 Programet buxhetore të Ministrisë**

Sipas programeve buxhetore të ministrisë, të vendoset qëllimi i politikës së secilit program.

#### **3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM**

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve të saj menaxhuese në hartimin dhe zbatimin e politikave, të cilat do të bëjnë të mundur përmbushjen e standardeve të vendosura nga BE-ja dhe që do të garantojnë përmirësimin dhe përdorimin e vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe financiare të Ministrisë. Ndërtimi i një sistemi të integruar duke krijuar një ambient informatik bashkëkohor.

#### **3.2 UJËSJELLËS KANALIZIME**

Politika e këtij programi konsiston në sigurimin e një ambienti të përshtatshëm ligjor, administrativ dhe financiar në zhvillimin e infrastrukturës së ujësjellës - kanalizimeve për të mundësuar krijimin e shërbimeve efikase të ujit dhe të sanitetit, të krahasueshme me standardet evropiane, në zonat urbane dhe rurale. Kjo do të arrihet nëpërmjet kryerjes së disa reformave në sektor si: Reforma teknike dhe menaxhimi i kërkeses; Reforma ligjore dhe institucionale; Reforma financiare; Reforma e komunikimit dhe informimit të publikut; Sinergjia me Strategjitë e tjera Sektoriale dhe Përputhshmëria me Direktivat e Bashkimit Evropian për Ujin; Fuqizimi i planifikimit; Reforma e monitorimit dhe masave detyruese.

#### **3.3 STREHIMI DHE URBANISTIKA**

Qëllimi i Politikës së Programit Strehimi dhe Urbanistika është që, deri në vitin 2015:

- 1) a) Të zgjerojë zbatimin e programeve sociale të strehimit nga bashkitë deri në vitin 2015, për të mundësuar akses në strehim për 9500 ose 35% e nevojave të familjeve me të ardhura të ulta sipas kategorive të percaktuara në nenin 5 të ligjit 9232;
- b) Të asistojë bashkitë e tjera të arrijnë standardet e nevojshme për t'u financuar;
- c) Të mbeshtesë zbatimin e projekteve të përmirësimit të banesave ekzistuese në bashkëpronësi, me synimin parësor ruajtjen e eficiencës së energjisë.

- 2) Përfundimi i legalizimit 100% të objekteve Informale dhe urbanizimi i rreth 300 mijë ha tokë, përmirësimi i GIS & IT;
- 3) Të mbrojtë burimet bregdetare natyrore & vlerat kulturore dhe të nxisë zhvillimin & menaxhimin e shëndetshëm të bregdetit shqiptar.

### **3.4 SHËRBIMET PUBLIKE**

Përmirësimi i administrimit të mbetjeve, me qëllim që të pakësohen rreziqet që i kanosen shëndetit njerëzor dhe mjedisor me anë të përmbushjes së kërkesave të KE-së.

#### **Qëllimet:**

Përmirësimi i legjislacionit të menaxhimit të mbetjeve nëpërmjet transpozimit të direktivave të KE-së;

Trajtimi në menyrë të kontrolluar sanitare i mbetjeve të ngurta urbane nëpërmjet ndërtimit të 12 landfilleve rajonale, deri në vitin 2020;

Vendosja në gjendje sigurie (mbyllja) të 65 venddepozitimeve ekzistuese të mbetjeve deri në vitin 2020.

### **3.5 TRANSPORTI RRUGOR**

#### **Rrjeti i Rrugëve Nacionale**

Politika e këtij programi konsiston në zhvillimin dhe rehabilitimin e rrjetit rrugor kombëtar me burimet e nevojshme financiare, që mbështet dhe inkurajon zhvillimin e ekonomisë dhe plotëson kërkesat e transportit evropian. Me anën e kësaj politike do të zbatohen reformat ekonomike nëpërmjet privatizimit të veprimtarive dhe të rritjes së efektivitetit të investimeve publike; krijimit të një sistemi rregullator ligjor në përputhje me kërkesat dhe standardet evropiane, integrimin me legjislacionin evropian dhe plotësimin e detyrimeve si anëtare e plotë në procesin e Stabilizim - Asociimit; zhvillimin dhe zbatimin e reformave institucionale mbështetur në sugjerimet e Planit Kombëtar të Transportit për sektorin rrugor, dhe nxitjen e trafikut të mallrave duke ulur koston e transportit rrugor, aksidentet dhe bllokimet. Përmirësimi i mirëmbajtjes së rrjetit rrugor kombëtar dhe përmirësimi i sigurisë së qarkullimit rrugor.

### **3.6 MENAXHIMI I TRANSPORTIT**

Politika e këtij programi konsiston në kryerjen e studimeve për të përmirësuar dhe zhvilluar transportin detar, hekurudhor, rrugor dhe ajror në drejtim të infrastrukturës, legjislacionit, në përputhje me direktivat e KE-së dhe MSA-së.

### **3.7 PORTET**

Politika e këtij programi konsiston në: plotësimin e ligjshmërisë kombëtare në fushën e transportit detar; Krijimin e Administratës Detare Shqiptare me strukturat përkatëse sipas standardit të IMO-s; Rritjen e kapaciteteve përpunuese dhe të nivelit të shërbimeve në portet detare, nëpërmjet rritjes së investimeve në infrastrukturë, superstrukturë dhe nivelit të menaxhimit; Komercializimin e shërbimeve në porte, dhe realizimin me efektivitet të investimeve mbi bazën e Master - Planeve të zhvillimit në perspektivë të porteve; Rritjen e shkallës së sigurisë në portet e hapura të Republikës së Shqipërisë (portet e Durrësit, Vlorës, Sarandës dhe Shengjinit) duke përmirësuar në vazhdimësi legjislacionin kombëtar në përputhje me kërkesat e Kodit të Sigurisë në Porte dhe Anije, si dhe direktivave e rezolutave të Komunitetit Evropian për rritjen e standardeve të sigurisë.

### **3.8 HEKURUDHAT**

Politika e Programit “transporti hekurudhor” parashikon përmirësimin gradual të infrastrukturës hekurudhore, të kuadrit ligjor të transportit hekurudhor dhe të inventarit të mjeteve lëvizëse me qëllim garantimin e standardeve të sigurisë dhe integrimin e rrjetit kombëtar hekurudhor në rrjetin rajonal.

### **3.9 TRANSPORTI AJROR**

Zhvillimi i politikave dhe i kuadrit ligjor, rregullator dhe operues, për garantimin e efikasitetit të transportit ajror, sigurisë, parrezikshmerisë dhe qëndrueshmërisë, duke ju përgjigjur objektivave të zhvillimit ekonomik të vendit. Arritja e standardeve ndërkombëtare, nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të infrastrukturës ligjore dhe operuese, përmirësimit të strukturave rregullatore dhe të mbikqyrjes për arritjen e optimizimit të elementeve të liberalizimit të tregut ajror, sigurisë, komoditetit e lehtësimit të levizjes së lirë të njerëzve dhe të mallrave e shërbimeve.

## 4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2010

Sipas programeve buxhetore të ministrisë, të renditen objektivat e politikave dhe produktet e secilit programit për vitin 2010.

### 4.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM

Objektivat e politikës:

Sigurimi i formimit profesional të stafit, nëpërmjet trajnimit me karakter të posaçëm për kryerjen e detyrave të veçanta, duke përcaktuar më parë nevojat për trajnim, si dhe trajnimit për zhvillimin e njohurive profesionale, zhvillimit të karrieres. Trajnimi i stafit të ri dhe atij ekzistues do të bëhet sipas kerkesave në rritje që diktojnë zhvillimet politike dhe ekonomike në vend, në bashkëpunim me ITAP dhe organizma të tjerë, që mund të ofrojnë asistencën e tyre në fushën e transportit, punëve publike, rregullimin e territorit, etj.

Përmirësimi dhe zbatimi i legjislacionit të shërbimit civil.

**Produktet kryesore që do të ofrohen:**

Gjatë vitit 2010 do të vazhdojë trajnimi i stafit të Ministrisë në përputhje me nevojat e sektorëve apo drejtorive, jo vetëm i nëpunësve ekzistues por edhe i atyre që do të rekrutohen gjatë këtij viti.

### 4.2 UJËSJELLËS KANALIZIME

Objektivat e politikës:

Rritja e cilesise se shërbimit për furnizimin me ujë në zonat urbane në 87% dhe në zonat rurale 51%, të totalit të popullsisë.

Rritja e përqindjes së popullsisë që është e lidhur në rrjetet kanalizimesh të përmirësuar në zonat urbane në 75% dhe rurale 45%.

Përmirësimi i ndjeshëm i performancës së sektorit për të mundësuar shërbime cilësish të qëndrueshme dhe zvoglim të masës së subvencioneve nga buxheti shtetit deri në nivelin e atyre të domosdoshme.

Kohezgjatja mesatare e orëve të furnizimit me ujë do të jetë 12 orë/dite.



Sigururimi i furnizimit të qëndrueshëm me ujë të sigurt, në sasi të mjaftueshme dhe me cilësinë e duhur për të gjithë popullsinë e vendit si në zonat urbane ashtu edhe ato rurale deri 24 orë/ditë;

Sigurimit të shërbimeve cilësore të grumbullimit, trajtimit e shkarkimit të ujrave të zeza në përputhje me standardet e mbrojtjes së shëndetit publik dhe mjedisit;

Përmirësimi i ndjeshëm i performances së sektorit dhe përafrimi me treguesit e Bashkimit Europian për të mundësuar shërbime cilësisht të qëndrueshme dhe zvogelim të masës së subvencioneve nga buxheti i shtetit deri në nivelin e atyre të domosdoshme duke patur në qendër të vëmendjes shtresat në nevojë;

Rehabilitimi i rrjeteve më të amortizuara të ujësjellesave dhe kanalizimeve, zgjerimi i këtyre rrjeteve dhe shtimi i impianteve të trajtimit të ujrave të përdorura;

Përcaktimi i tarifave sa më të drejta për të gjitha kategoritë e klientëve, të cilat në kohe duhet të vijnë duke iu përafruar kostove të shitjes, me tendencë mbulimin e të gjitha elemteve të saj duke përfshirë edhe kostot kapitale, për të dy shërbimet ujësjelles kanalizimeve.

#### **Produktet kryesore që do të ofrohen:**

##### **QARKU BERAT**

Rikonstruksion i rrjetit shperndares, stacion pompimi, Poshnje, Berat, furnizimi me ujë i 18.000 banorëve;

Ndërtim ujësjellesi i Urës Vajgurore dhe fshatrave përreth, punime ne kaptash, furnizimi me ujë i 26.000 banorëve;

Ndërtim ujësjellësi rajonal Agim-Kuc-Hingë, komuna Poshnjë Berat. Objekt në vazhdim. Furnizimi me ujë për 2.500 banorë;

Rikonstruksion i linjës së ujësjellësit Depo Nr. 1 puseta vezak, Lagje Çlirimi, Sh.a u, Berat. Objekt në vazhdim, përmirësimi i rrjetit të furnizimit me ujë për 27.000 banorë;

Rikonstruksion linje ujësjellësi Stacioni i pompave Çiflik depo uji “1 Maji” Kuçovë. Objekt në vazhdim, përmirësimi i rrjetit të furnizimi me ujë për 31.083 banorë;

Investime bazuar në performancë;

##### **QARKU DIBER**

Burime Peshkopi-Rethim Vepra e marrjes së ujit, depo uji dhe pus shuarje Radomirë. Furnizimi me ujë për 2.000 banorë;

Ndërtim ujësjellësi qyteti Klos. Objekt në vazhdim, Furnizimi me ujë për 4.000 banorë;  
Rrjeti i brendshëm i ujësjellësit Bulqizë. Objekt në vazhdim, Furnizimi me ujë për 8.000 banorë;

## **QARKU DURRES**

Ndërtimi i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit për zonat e plazhit të Durrës - Kavajë nga pus shpimet e Rogozhinës; objekt në vazhdim, furnizim me ujë i 150,000 banorëve dhe turistëve;

Furnizimi me ujë i zonës të Këneta Durrës, objekt në vazhdim, furnizimi me ujë i 18`000 banorëve;

Furnizim me ujë i fshatrave të Bashkisë Sukth, objekt në vazhdim, furnizim me ujë i 30`000 banorëve;

Ndërtim i rrjetit të ujësjellësit Perroj i Agajt-Plepa, Durres. Objekt në vazhdim, furnizim me ujë i 16.000 banorëve;

Rikonstruksioni i linjes së ujësjellësit Unaze, bashkia Durres, objekt në vazhdim, furnizimi me ujë i 10.000 banorëve;

Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në zonën e banuar Sauk në rrugën e Plepave, objekt në vazhdim, furnizimi me ujë i 1.800 banorëve;

Studim projektim për furnizimin me ujë të zones së Durrësit.

Studim projektim për furnizimin me ujë të zonave të plazhit Durres - Kavajë nga pus shpimet e Rogozhines (Kontratë e Lidhur);

## **QARKU FIER**

Rikonstruksion Ujësjellësi Clirim, komuna Qender, Fier, objekt në vazhdim. Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit për 2.000 banorë;

Furnizim me ujë me pus cpime i plazhit Divjake dhe zgjerimi i rrjetit Divjake, objekt në vazhdim, furnizim me ujë i 20`000 banorëve dhe 15.000 pushues;

Rehabilitimi i puseve në Kafaraj, linjat e furnizimit

Rikonstruksion ujësjellësi Agimi, komuna Libofshë Fier. Objekt në vazhdim, përmirësimi i rrjetit të furnizimi me ujë për 9.000 banorëve;

Ndërtim ujësjellësi fshati Kasnicë, komuna Ruzhdie Fier. Objekt në vazhdim, furnizimi me ujë për 460 banorë;

## **QARKU ELBASAN**

Rikonstruksion rrjeti i brendshëm i ujësjellesit Cerrik, bashkia Cerrik, Faza e II, objekt në vazhdim, furnizimi me ujë i 15.000 banorëve;

Furnizimi me ujë i qytetit Peqin, objekt në vazhdim, furnizim me ujë i 10`000 banorëve;

Ujësjellësi i fshatit Korre, Komuna Funar, Elbasan. Objekt në vazhdim, furnizimi me ujë i 300 banorëve;

Ndërtim i KUZ fshati Prrenjas, bashkia Prrenjas. Objekt në vazhdim, furnizimi me ujë i 1.200 banorëve;

Rikonstruksioni ujësjellesi i fshatit Hotoloshit - Qender, komuna Hotolisht, Librazhd. Objekt në vazhdim, përmirësimi i rrjetit të furnizimit me ujë për 700 banorëve;

Studim projektim për furnizimin me ujë të zones së Dumresë, Elbasan;

## **QARKU GJIROKASTER**

Rrjeti i brendshëm i ujësjellesit Bularat (faza e dytë) komuna Dropulli i Sipërm, Gjirokastër. Furnizimi me ujë për 1.300 banorë;

Ujësjellësi Livadhja, komuna Livadhja, Sarandë;

Ujësjellësi i jashtëm i fshatit Lazarat. Objekt në vazhdim, furnizimi me ujë për 3.000 banorë;

Ndërtim i kolektorit kryesor të ujrave të zeza Sarandë, derdhja në IPUZ. Objekt në vazhdim. Shërbimi për 50.000 banorë;

Rikonstruksion Ujësjellësi Delvinë, (rrjeti i brendshëm), objekt në vazhdim, furnizimi me ujë i 12.000 banorëve;

Ndërtimi i linjës së ujësjellesit linjat 1, 2, 3, Sarandë. Objekt në vazhdim;

Ujësjellsi i fshatrave Serrile, Bylysh, Mirine, kom Memeliaj. Objekt në vazhdim, furnizimi me ujë i 600 banorëve;

Ujësjetllësi rajonal Aliko, komuna Aliko, Sarandë. Objekt në vazhdim, furnizimi me ujë i 8.600 banorëve;

Ndërtim ujësjetllësi Sopanike (varianti me veterrjedhje), objekt në vazhdim, furnizimi me ujë i 8.000 banorëve;

Ujësjetllësi i Ksamilit (faza e II) objekt në vazhdim, furnizim me ujë i 37`000 banorëve;

#### **QARKU KORÇE**

Ujësjetllësi i fshatit Arze, komuna Miras, Korçë. Objekt në vazhdim, furnizimi me ujë i 8.500 banorëve;

#### **QARKU KUKËS**

Ujësjetllësi i jashtëm i qytetit Bajram Curri, objekt në vazhdim, Furnizim me ujë i 24`000 banorëve;

Furnizimi me ujë i qytetit Kukës dhe të 14 fshatrave rreth saj, objekt në vazhdim, Furnizimi me ujë i 37`800 banorëve;

Ndërtim ujësjetllësi rajonal Novosej-Shishtavec-Borje, Komuna Shishtavec, Kukës furnizim me ujë i 5.000 banorëve;

Rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm Krume, objekt në vazhdim, furnizim me ujë i 10`000 banorëve;

#### **QARKU LEZHË**

Ujësjetllësi Shëngjin (faza e II) objekt në vazhdim, furnizimi me ujë i 35`000 banorëve;

Rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm ujësjetllës kanalizime Laç, objekt në vazhdim përmirësimi i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për 58`000 banorë;

Ujësjetllës kanalizime Mamurras, objekt në vazhdim, përmirësimi i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për 18,000 banorë;

Ujësjetllësi Kodër Marlekaj, Bashkia Lezhë, objekt në vazhdim, përmirësim furnizimit me ujë dhe i kanalizimeve për 16`000 banorë;

Furnizim me ujë i zonës Balldre I Ri, fshatrat Torovice, Kolajkaj, Shkami i Kuq, komuna Balldre, Lezhë. Objekt në vazhdim, furnizim me ujë i 8.500 banorëve;

Ndërtim ujësjellesi rajonal komuna Bradashesh për fshtrat Bradashesh, Fikas, Shijon, Karakullak, Bales, Kusari, Katundi i Ri, objekt në vazhdim, furnizim me ujë i 8.000 banorëve;

Furnizimi me ujë i zonave rurale Rrëshen, rrjeti shperndares, Faza e II. furnizim me ujë i 7.532 banorëve;

#### **QARKU SHKODER**

Ujësjellësi Velipojës (faza e II) objekt në vazhdim, furnizimi me ujë i 60`000 banorëve;

Furnizimi me ujë i qytetit Pukë, rrjeti i jashtëm dhe i brendshëm, objekt në vazhdim furnizim me ujë i 11`000 banorëve;

Rikonstruksioni i ujësjellësit të Rjollit Shkodër, objekt në vazhdim, furnizimi me ujë i 48`000 banorëve;

Ndërtim ujësjellësi rajonal për fshatrat Kosmac, stajke, Plezhe, Komuna Bushat, Shkoder objekt ne vazhdim, furnizimi me ujë i 68`000 banorëve;

Ndërtim ujësjellësi fshati Bardhas, Komuna rrethina Shkoder, furnizim me ujë i 2.000 banorëve;

Furnizimi me ujë i zonave rurale Malësi e Madhe, rrjeti shpërndarës, Faza e II-te - 6 fshatra, objekt ne vazhdim, furnizimi me ujë i 11.285 banorëve;

Rrethimi i kaptazheve të ujësjellesit Shkoder, objekt në vazhdim, furnizimi me ujë i 50.000 banorëve;

Ndërtim i kolektorit kryesor në qytet të ujrave të bardha 9 paruce-Teatër) l=387 ml, bashkia Shkodër. Objekt në vazhdim, ndërtim i kanalizimeve për 10.000 banorë;

#### **QARKU TIRANE**

Shtimi i sasisë së ujit dhe sistemimi i lidhjeve të abonentëve në linjën kryesore të ujësjellësit Stacioni i Pompimit Fushë-Krujë-Vorë. objekt në vazhdim, furnizimi me ujë i 20`000 banorëve dhe turistëve;

Rikonstruksion i ujësjellesit të fshatit Petrele, komuna Petrele. Objekt në vazhdim. Përmiresimi i rrjetit të ujësjellesit për 860 banorë;

KUZ Lunder, komuna Farke. Objekt në vazhdim. Shërbimi për 1.500 banorë;

KUZ dhe KUB të rrugës "Rruga nacionale - Mjull Bathore", komuna Farke. Objekt në vazhdim. Shërbimi për 1.500 banorë;

KUZ zona e banimit "Ura e Beshirit", komuna Ndroq, Tirane. Objekt në vazhdim, Shërbimi për 2.500 banorë;

KUZ të fshatrave Marqinet-Gerdec, bashkia Vore. Objekt në vazhdim, ndërtim i kanalizimeve për 5.000 banorë;

Rikonstrukcion i ujësjellesit të fshatrave Gërdec, Marqinet 2 dhe Marqinet 1, bashkia Vore. Objekt në vazhdim, përmirësimi i rrjetit të furnizimi me ujë për 5.000 banorëve;

Rrjeti i ri i KUZ të fshatit Mbrostar - Ura ( Faza e pare). Objekt në vazhdim, komuna Mbrostar, Fier shërbimi për 3.500 banorë;

Kanalizimi i ujrave të zeza Zona e Vilave Mullet komuna Petrele, Tiranë. Objekt në vazhdim, ndërtim i kanalizimeve për 2.000 banorë;

Furnizimi me ujë i Zonës Rezidenciale, komuna Petrelë. Objekt në vazhdim, furnizimi me ujë për 700 banorë;

## **QARKU VLORE**

KUZ të rrjetit sekondar dhe tercial në qytetin e Vlorës. Shërbimi për 55.000 banorë;

Ndërtim ujësjellësi qyteti Selenicë. Objekt në vazhdim, Furnizimi me ujë për 8.652 banorë;

Furnizim dhe vendosje matsash uji të mëdhenj, objekt në vazhdim;

Trajtimi i vepres H/C Banje;

Studim i fizibilitetit dhe projektet e detajuara për programin IPA 2007 të Komunitetit Evropian në zonën bregdetare (Kontratë e Lidhur);

## **4.3 STREHIMI DHE URBANISTIKA**

Objektivat e politikës:

Të sigurojë kushtet për strehimin e rreth 11 % të familjeve të cilat kanë aplikuar pranë bashkive;

Vazhdimi i punimeve civile për përmirësimin e infrastrukturës dhe sistemit të ujësjelles-kanalizimeve për bregdetin;

Hartimi i planit Rregullues të qarkut Elbasan dhe financimi i studimeve për përfundimin e planeve rregullues të qyteteve Durrës, Shkodër, Kamëz, Vlorë

Legalizimi dhe përpunimi i informacionit tekniko ligjor për rreth 100 000 pasuri informale.

#### **Produktet kryesore që do të ofrohen:**

Siperfaqe ndërtimi për Banesat sociale me qira;

Numer familjesh që perfitojnë subvencion të interesit të kredisë;

Punime civile për menaxhimin e pastrimin e zonës bregdetare;

Plane rregulluese të njësive vendore për Menaxhimin e Tokës dhe Zhvillimi Urban;

#### **4.4 SHËRBIMET PUBLIKE**

Objektivat e politikës:

Trajtimi i mbetjeve në menyrë të kontrolluar sanitare që i përgjigjet një popullsie prej 850.000 banorësh; Vazhdimi i punimeve për landfillin e Sharrës, Bushatit, Rreshenit dhe fillimi i punimeve për landfillin e Prrenjasit.

**Produkti:** Përpunimi i 250 000 ton mbetje në vit.

Përgatitja dhe përshtatja e Direktives 2000 / 53 të KE për «Administrimin e makinave të dala jashtë përdorimit ».

**Produkti:** rregullore për zbatim.

Identifikimi i vendepozitimeve ekzistuese dhe përgatitja për mbylljen e tyre.

**Produkti:** Projekte të gatshme për zbatim.

Identifikimi i vendepozitimeve të reja dhe përgatitja për ndërtimin e tyre.

**Produkti:** Projekte të gatshme për zbatim.

#### **4.5 TRANSPORTI RRUGOR**

Rrjeti i Rrugëve Nacionale

Objektivat e politikës

Objektivat e politikës së këtij programi mund të ndryshojnë nga parashikimet e bëra në PBA 2010-2012, pasi ato janë ripunuar në përshtatje me buxhetin e miratuar në Nëtor 2009, për vitin 2010.

**Produktet kryesore që do të ofrohen:**

Ndërtimi i 120 km rrugë kombëtare me dy dhe katër korsi, me financim të brendshëm dhe të huaj prej 30,640 milion lekë. Përfundimi i ndërtimit të seksionit: Milot-Rrëshen, Rrëshen-Kalimash përfshirë tunelin e Thirës dhe Kalimash-Morinë (pjesë të Korridorit Durrës-Kukës-Morinë), Bulqizë-Bllatë U.Çerenecit, Dragobi-Valbonë etj. Vazhdimi i ndërtimit të segmentit rrugor: Qukës-Qafë-Plloçë, Kardhiq-Delvinë, Milot-Fushë Krujë (dublimi i superstradës), By Pass Plepa-Kavajë-Rrogzhinë, rrugës së Porto Romanos Durrës etj. Fillimi i ndërtimit të seksionit rrugor: Ura e Brarit-Hyrje Tuneli Qafë Murrizë (vazhdim i rrugës së Arbërit), dublimit të rrugës Milot-Rrëshen, rikonstruksionit të Unazës së Durrësit dhe synimi për fillimin e ndërtimit të Unazës së Re të Tiranës dhe të rrugës Tiranë - Elbasan;

Rikonstruksioni i 80 km rrugë me dy dhe katër korsi (sistemimi e asfaltimi i tyre) me financim të buxhetit prej 3,083 milion lekë. Sistemim asfaltimi i rrugëve: Superstradës Tiranë-Durrës, Tre Urat-Leskovic, Gjirit të Lalzit, rrugës Liqenasit, të Dardhës dhe të Voskopojës Korcë, të Gjinarit Elbasan, Librazhd-Qafë Stude, Kuçovë-Belsh-Cerrik, Ura e Çerenecit-Peshkopi, Qafë Thanë-Lin-Pogradec, Lushnje (pushimi i shoferit)-Divjakë, të rrugëve hyrëse Kavajë, Sarandë, etj.;

Ndërtimi i 95 ml ura dhe mbikalime me financim të huaj e të brendshëm gjithsej 404 milion lekë;

Përmirësimi i mirëmbajtjes së rrjetit rrugor kombëtar (prej 3656 km) nëpërmjet sistemit të menaxhimit të pasurive rrugore dhe synimi për privatizimin bazuar në kontrata performance me shtrirje prej rreth 40 % (1500 km të rrjetit rrugor);

Kompletimi me elemente të sigurisë rrugore, sinjalistikë rrugore dhe riparimi i pikave të rrezikut në akset rrugore kombëtare.

Projektet e rrugëve janë grupuar sipas kategorive dhe produktet kryesore që do të ofrohen janë:

Rrugë të ndërtuara Tip A2 (2x2) korsi 22 km;

Rrugë të ndërtuara Tip A2' (2x2) korsi 4 km;

Rrugë Interurbane Kryesore të ndërtuara Tip B' (2x1) korsi 15 km;

Rrugë Interurbane Kryesore të ndërtuara Tip B1' (2x1) korsi 50 km;

Rrugë Interurbane Dytësore të ndërtuara Tip C2 (2x1) korsi 23 km;

Rrugë Interurbane Dytësore të ndërtuara Tip C2' (2x1) korsi 6 km;

Rrugë të rikonstruktura Tip A2' (2x2) korsi 5 km;

Rrugë Interurbane Dytësore të rikonstruktura Tip C2 (2x1) korsi 44 km;

Rrugë Interurbane Dytësore të rikonstruktura Tip C2' (2x1) korsi 31 km.



## 4.6 MENAXHIMI I TRANSPORTIT

Objektivat e politikës

Studime dhe Projekte mbështetëse për rishikimin e Planit Kombëtar të Transportit për fushat përkatëse të llojeve të transportit si rrugor, detar, hekurudhor, ajror dhe të kombinuar drejt një transporti të qëndrueshëm.

**Produktet kryesore që do të ofrohen:**

Krijimi i një databaze të sektorit të transportit për secilin lloj të tij dhe të dhëna që do të përdoren bashkërisht për të gjitha veprimtaritë e sektorit të transportit, mirëmbajtja dhe përditësimi i këtij databaze;

Mirëmbajtja dhe përditësimi i Planit Kombëtar të Transportit (PKT) dhe programeve të investimeve lidhur me to;

Rishikimin dhe përditësimin e politikave të sektorëve të transportit, rregulloreve dhe të reformave institucionale;

Kryerjen e punimeve dhe shërbimeve të tjera studimore në fushën e transportit si dhe vlerësime, oponenta, ekspertiza, trajnime, etj. për Ministrinë e linjës dhe për të tretë;

